

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8 SH-32

T 96

Nevrus Turhani


**VATËR
E
NDEZUR**

NOVELE

854-32
T 96

NEVRUS
TURHANI

3210



VATËR
E
NDEZUR

Novelë

SHTËPIA BOTUJSE «NAIM FRASHËRI»

PROLOG

Kur të gjithë u larguan, mbeti vetëm Nikoja me Feritin. Ata do të pastronin dhe do të ajrosnin dhomën e kulturës. Mbledhja do të vazhdonte pas buke.

— T'i japim shpejt, Niko, se do të mbetemi pa ngrënë, — foli Feriti dhe filloi nga spërkatja e dyshe-mesë. Nikoja shkoi te dritarja dhe hapi kanatet. Qielli iu duk i pastër, si ujët në një gotë qelqi, yjtë më të ndritshëm, zhurma e lumit më e qartë, më e shtruar se asnjëherë. Ishte një natë e qetë dhe atij iu shkrep të rrinte akoma në dritare. Por Feriti e ngacmoi:

— Po ëndërron?

— Aty afër! — iu përgjigj pa e kthyer kokën dhe pa qejf Nikoja.

— Ç'do të thuash me këtë? — vazhdoi tjetri.

— Më pëlqen të sodit, — foli si me vete Nikoja.

— Lojë fjalësh, — u hodh Feriti. — E di ç'ke? Më ndihmo të sistemojmë stolat dhe t'ia mbathim, se mua për vete, më sharroi...

— Ndërsa unë s'kam uri, — ia ktheu Nikoja dhe zuri vend më mirë në dritare. Të dy duart, të mbledhura grusht, i vendosi nën mjekër. Tashmë, ai s'e kishte mendjen fare të Feriti, as zhurmën që bëri një

stol kur u rrëzua nuk e dëgjoji. Feriti iu afrua te veshi dhe i thirri:

— Ëndërro, pra. Unë po shkoj. Detyrën time e bëra. Stolat në daç rregulloi, në daç lëri kështu si janë.

Pas këtyre fjalëve Nikoja dëgjoji derën që u përplas pas shpinës së tij, por nuk e ktheu kokën. . .

Feriti i gjeti shokët në të mbaruar. Dikush nga ata e pyeti:

— Po Nikoja ç'u bë?

— Po studion disa fenomene të natyrës, gjë që e ka bërë të mos ketë uri.

Si tha kështu, Feriti bëri një ngërdheshje, pastaj zuri vend e nisi të hajë me të shpejtë. Kur pa se shoku që e kishte pyetur për Nikon nuk ishte larguar, shtoi:

— Ç'të bëjë, i shkreti, ka nevojë të freskohet nga trutë. . .

Shokut nuk i pëlqyen këto fjalë. A mund të thuheshin ato për një shok? E ktheu gjithë trupin nga Feriti. Por ç'e do, fytyrën nuk ia shikonte dot të gjithë. Vetëm një pjesë, e pikërisht një anë të nofunes së poshtme, që e lëvizte pa pushim. U mat t'i thoshte një fjalë të rëndë, por u përmbajt. E shtrengoi atë midis dhëmbëve dhe u ngrit, shkoi deri te dera e qëndroi: «Ka nevojë. . .» Këto fjalë iu dukën si një çekan që e godiste në intervale të rregullta, pa pushim. Dhe pas çdo goditjeje sikur dëgjonte zërin e Feritit: «Ka nevojë të freskohet nga trutë». Ktheu kokën pas. Nofullat e Feritit lëviznin. Hante me uri. E ndaloi për typjen përkohësisht kur dëgjoji kuzhinierin, Gimin, që zuri në gojë emrin e Nikos. Vetëm atëherë e ngriti kokën dhe tha:

— Ndoshta s'vjen... vështirë të ketë uri. Pastaj, boll hëngri... Unë për vetë time...

— Si? — E ngriti zërin Gimi.

— Do të vish në mbledhje? — dredhoi Feriti dhe i dha fund pjatës me supë.

Kuzhinieri, që nuk i kuptoi mirë fjalët e para të Feritit, pyeti:

— Ju ishit bashkë, ç'u bë ai, apo pandeh se unë s'do të vij në mbledhje?

— Na pret atje. E lashë duke ëndërruar në dritare... Epo, s'i thonë shaka, kritikë kjo e shkreta, të luan tepelekun e kokës...

Feriti dukej i kënaqur. U ngrit plot gjallëri dhe bëri për nga Gimi. Kur iu afrua më pranë, i tha:

— Kjo mbledhje po ia ul atë hundë, që e mbante në tra. Pandehte se vetëm ai ishte i pakritikueshëm...

Feriti qeshi duke menduar se do të qeshte dhe Gimi. Por tjetri ia priti me nervozizëm:

— Paç faqen e zezë!...

I kthyen krahët njëri-tjetrit.

* * *

Kur hyri Feriti, komisari sapo shqiptoi:

— Epo, kush do ta marrë fjalën?

Njëherësh u ngritën disa duar.

— Unë kam për të sqaruar një çështje që ka të bëjë me Feritin, — tha me zë të lartë një nga ata të rreshtave të parë.

— Dua të di, cili është mendimi i Malos, lidhur me çështjen që po shqyrtojmë? Pse hesht sekretari

ynë i Rinisë? — pyeti një tjetër.

U hap dera. Hyri Gimi. Pa zënë vend mirë, iu drejtua njërit prej shokëve që i liroi një cep të stolit:

— Mua më prisni?

— Jo, kemi filluar. Ti do të diskutosh?

— Sigurisht.

— Thuaji komisarit.

Por nuk qe nevoja. Komisarit e dëgjoi bisedën e tyre, buzëqeshi dhe diç shënoi në bllok. Pastaj hodhi përsëri vështrimin nga ushtarët. Ata, të gjithë, sikur kishin rënë në mendime. Edhe Feriti mendonte. Për çfarë vallë? Fjalët e kuzhinierit në mensë i kishin ardhur të papritura. Por ato vetëm sa e kishin hutuar, nuk i kishin lënë ndonjë peng. E kishin hutuar në çastin e parë, se pastaj e kish mbledhur veten dhe kish thënë me vete: «Fundja jemi mbledhur për Nikon dhe jo për mua». Me këto mendime qe futur në dhomën e kulturës, me këto vazhdoi derisa dikush tha se kishte për të sqaruar një çështje që lidhej me të! «E ç'mund të ketë me mua Minella?» nisi të arsyetojë me vete. Përgjigjej po me vete: «Asgjë! Këtu është fjala për Nikon, jo për mua. Unë jam në punën time. Bëj si më thonë, as më pak e as më shumë. Fundja, po më ngjiti ndonjë bisht, një autokritikë, një zotim të mirë dhe, shko tutje... Po kam thënë ndonjë fjalë lart e poshtë. Epo mirë, i kam thënë, s'do ta përsërit më. Po janë thashetheme. Unë them jo, dhe...»

I rrëmbyer nga këto mendime, Feriti nuk dëgjoi mirë se çfarë tha komisarit dhe ngriti dorën instinktivisht. Pastaj e uli shpejt, por ç'e do, ishte vonë. Atë e panë shokët, komisarit, anëtari i komitetit të Ri-

nisë, që rrinte në krah të komisarit.

— Mirë, atëherë, po ia japim fjalën Feritit, — tha komisari.

Hutimi nuk qëndronte shumë në fytyrën e Feritit. Largohej shpejt dhe vendin e tij e zinte shprehja e një qetësie të brendshme. U ngrit dhe foli:

— Më falni e kisha mendjen gjetskë, te një hall. Unë s'kam se çfarë të them, vetëm të përsërit shokët. Kritikkat e tyre i vlejnë shumë Nikos, bile edhe mua, megjithëse, siç e dini, unë s'bëj gabime si ato të Nikos... Por, meqenëse u ngrita, i them kolektivit se i pranoj kritikkat që do të më bëhen dhe marr zotim se do të jem gjithnjë i rregullt e i disiplinuar... Meqenëse u ngrita kam dhe një propozim: sikur të mbylleshin diskutimet? Çështjet dolën, Nikoja u kritikua aq sa dhe bukë s'hëngri. Ngelet ndonjë gjë e paqartë. Mirë, ia lëmë kohës. Kaq kisha.

Feriti u ul, si i çliruar nga një barrë e rëndë. Duart që ngritën shokët pas fjalëve të tij i mori si miratim të propozimit që bëri. I kënaqur nga vetvetja i tha atij që kishte pranë:

— Të mbyllet tani kjo histori, s'kemi ç'i bëjmë Nikos.

— E ke gabim, Ferit, — ia ktheu tjetri, gjërave u duhet shkuar deri në fund.

— Posi, deri në fund, — përsëriti Feriti me qesëndi. Ndërkohë përbrenda filloi të ndiente një shqetësim, që po i rritej dhe s'dinte se nga i vinte.

Përkundrazi Nikoja rrinte më i qetë. Të paktën kështu dukej. Se ç'ndiente në zemër, se ç'bluante në kokë, asnjëri nuk e dinte. Megjithatë, shokët që e njihnin mirë i merrnin me mend telashet e tij. Minella, sa herë i hidhte sytë nga ai, thoshte: «Nikojka nxjerrë kandarin dhe po i peshon gjërat. Ç'duhet të mbajë për vete, ç'duhet të flakë dhe ç'duhet t'u japë të tjerëve. E ka zakon ai, nuk flet kurrë pa u menduar. . .» Ndërsa Nasi kishte tjetër mendim: «Po t'ia hapësh zemrën atij, në këto caste, në vend të gjakut do të gjesh flakë. Por përmbahet. Zaten këtu qëndron zotësia e njeriut. . .» Edhe Mersini, që herë pas here kthente kokën nga ai, kishte mendimin e vet. Duke parë nga Nikoja, thoshte me vete: «S'ia bën syri tërt, qerratait». Pastaj, tek e shihte të përkulej kohë pas kohe për të shënuar diçka në bllok, Mersini e ndryshonte mendimin për të. «Njeri është, — thoshte, — edhe mund të ketë gabuar, nuk i dihet kësaj pune». Diçka tjetër lexohej në sytë e komisarit: «Nikojka është ai që njohim». Kurse Maloja, sekretari i organizatës-bazë të Rinisë, pse druhej ta shikonte Nikon drejt në sy? Ai, me sa dukej, as që donte të dinte se në ç'gjendje shpirtërore ndodhej shoku i tij. Vetëm i vinte plasje kur kujtonte bisedën që kishte zhvilluar me të. «Mos e bëj çështje, — i kishte thënë Nikos. — Nuk do të fitosh gjë. Pse i hap punë vetes? Më dëgjo mua: më mirë ta mbyllim, t'i vëmë kapak kësaj «intrige», siç të vjen mirë ta quash...» Dhe, aty për aty, i përforconte këto mendime: «E, të thashë unë? Të gjithë tek ti dyshojnë». Por Malos nuk mund të mos i kujtoheshin edhe fjalët e Nikos, toni

me të cilin i kishte shqiptuar ato: «Jo, çështjeve parimore, ideologjike, s'mund t'u vihet kapak. Këtu s'kemi të bëjmë thjesht me një intrigë, por me barëra të huaja në trup të njerëzve, që duhet t'i shkulin, t'i djegim. Ndryshe nuk pastrohemi dot dhe intriga do të trashet, do të majet, do të përhapet, do të bëhet e rrezikshme... Këshillat që më jep s'janë ato të një sekretari. Dhe unë e kuptoj pse e bën këtë. Po ta them copë: Nuk të pëlqen të turbullohen ujërat, t'i hapësh punë vetes. Në qoftëse të dhimset uniteti i kolektivit, mos bëj të tilla propozime. Uniteti forcohet jo duke e mbuluar kontradiktën, por duke e zbuluar dhe duke e zgjidhur atë. Zjarri nuk mbanet i ndezur dhe i hedhur ujë... Ndoshta s'të vjen mirë që po t'i them këto, por në shoqëri, në kolektiv, vetëm në këtë mënyrë mund të flitet. Unë kështu i kuptoj gjërat e kështu do të veproj...

Këto sillte në mend Maloja, në kohën që Nasi bëri atë pyetje që i erdhi aq e papritur. Dhe priti që pas Nasit të ngriheshin edhe të tjerë, të ngrihej vetë Nikoja. Por më kot, asnjë tjetër nuk bëri pyetje në adresë të sekretarit. Ai u qetësua, megjithëse e kuptoi se në pyetjen e Nasit përmbledhej mendimi i shumë të tjerëve.

— Epo, shoku Malo, ju duhet të shfaqni mendimet tuaja si pjesëtar i kolektivit, si sekretar, si shok, si tha komisari.

— Ashtu vërtet, por unë..., unë, si t'ju them, mendoj të flas pak më vonë. Shokut Nasi në qoftë se nuk i pritet po ia them mendimin tim me dy fjalë. Nikoja duhet të bëjë autokritikë për shqetësimin që po i shkakton kolektivit. Nga faktet që u sollën këtu del se një pjesë e fajeve i takojnë atij. Ne duhet t'u besojmë shokëve.

— Po Nikos a i duhet besuar? — pyeti Minella duke u ngritur nga vendi.

Komisari bëri me dorë dhe Minella u qetësua. Në këtë kohë ngriti dorën Gimi, guzhinieri. Pastaj Nikoja e disa të tjerë.

E mori fjalën anëtari i komitetit të Rinisë:

— Jam i mendimit se shoku Malo duhet të flasë. Koha për përgatitje, si për të gjithë ju, edhe për atë ka qenë e mjaftë. Më duket se shoku Nasi ka të drejtë që kërkon mendimin e sekretarit. Ju, shoku Malo, tregohuni më i matur, më i pjekur. Çështja nuk është aq e thjeshtë sa kërkonte ta paraqitni. Ajo ka rrënjë të thella. Pra kemi të bëjmë me koncepte. Cilat janë këto? Mendoj se secili këtu duhet të ndalet. Gjyqin ua bëjmë koncepteve, për të shpëtuar bartësit e tyre... U zgjata pak, shokë, por puna nuk është t'ia lëmë apo të mos ia lëmë Nikos barrën. Ai ka pjesën që i takon dhe ne e dëgjuam. Ai bëri autokritikë për aq sa iu duk e drejtë. Mbetet të zbulojmë të vërtetën, sepse edhe Nikon s'kemi si të mos e besojmë... .

Shumë veta i dhanë të drejtë anëtarit të komitetit. Mbi Malon ranë dhjetëra vështrime. Edhe sytë e vegjël të Feritit përpiqeshin të depërtonin në thellësi të shpirtit të Malos. Edhe ai pyeste, edhe ai diç kërkonte me atë vështrim, edhe ai donte t'i thoshte diçka shokut, para se ai të merrte fjalën. Kur Maloja u ngrit, Feriti s'e ndjeu veten mirë. Atij iu duk atë çast sikur xhaketa ia shtrëngonte si tepër trupin e vogël dhe shkopsiti shpejt e shpejt jakën e saj. «Më mirë të dëgjoj njëherë se për çfarë po na flet ky shoku Malo», tha me vete.